



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 550/23

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga OSHP sipas nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtare, bazuar në neni 98, paragrafi 1, nenin 105, paragrafi 2, lidhur me nenin 99 paragrafi 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar) dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP duke vendosur lidhur me kërkesën për "paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik" e parashikuar me nenin 99, paragrafi 2, i LPP e parashtruar me 18.05.2023 nga Ndërmarrja Publike Banesore, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj Operatorit Ekonomik (OE) "Dauti Komerc" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pije për byfe" me numër të prokurimit: 1909466981031194-23-3640-1-3-6, me 17.10.2024, mori:

V E N D I M

1. Refuzohet, si e pa bazuar kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Ndërmarrja Publike Banesore e datës 18.05.2023, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE "Dauti Komerc" sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pije për byfe" me numër të prokurimit: 1909466981031194-23-3640-1-3-6.
2. Urdhërohet AK, respektivisht Ndërmarrja Publike Banesore, që ta bej konfiskimin e sigurisë së tenderit për OE, me të dhëna si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me 18.05.2023, Ndërmarrja Publike Banesore në cilësinë e AK, ka dorëzuar në OSHP, kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP, ndaj OE "Dauti Komerc" sh.p.k., nën pohimin se ekziston dyshimi për paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar, sikurse parashihet me nenin 99 par 2 të LPP.

Duke ju referuar kërkesës së cituar si më sipër, konstatohet se si arsye për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP, AK (me të dhëna si më sipër) ka deklaruar se OE "Dauti Komerc" sh.p.k., në aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pije për byfe" me numër të prokurimit: 1909466981031194-23-3640-1-3-6, është oferta me çmimin më të lirë. Një ditë pas hapjes së ofertave, pikërisht me dt. 26.04.2023 në ora 9:01 minuta, është pranuar një email nga Ertan Kadri, (ertan.kadri@dauti-ks.com) në të cilën thuhet se "*Përshëndetje, ju informojmë që gjatë përgatitjes së ofertës kemi gabu te çmimi i ujit i cili kërkohet për litër ne kemi ofertu me çmim për cope. Për këtë arsye ju informojmë që nuk do ta nënshkruajmë kontratën dhe mund të vazhdoni me ofertuesit tjerë. Me respekt dhe shpresë për mirëkuptim*". (provë emaili për tërheqje nga oferta). Marr parasysh, se aktiviteti i prokurimit në fjalë, ishte "Kuotim i çmimit" vlerë e vogël dhe nuk ishte kërkuar "Siguria e tenderit" dhe duke u bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik saktësisht nenet e cituara me lartë 32.17 dhe 32.18 që ndalon tërheqjen pas datës së fundit për dorëzim të ofertave konsiderohet se OE ka vepruar në kundërshtim me nenet në fjalë dhe po ashtu ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e përshtatshmërisë, përkatësisht Deklaratës nën Betim të cilën ka dorëzuar me ofertë e që nënkupton se i njëjti i përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Mos përmbushja e detyrimeve konform "Deklaratës nën Betim" nga ana e OE Dauti Komerc SH.P.K., Gerlicë, 70000, Ferizaj, Autoriteti Kontraktues, Ndërmarrja Publike banesore sh.a i krijon shpenzime shtesë për shkak se duhet të kaluar tek operatori i tretë me radhë i përgjegjshëm me një diferencë prej 2,736.84 euro.

Nga sa u tha më sipër Autoriteti Kontraktues, kërkon nga OSHP që të shqyrtoj mundësinë për vendosjen në listë të zezë të operatorit ekonomik.

Me 18.05.2023, OSHP, pas pranimit të kërkesës së AK-së, e ka njoftuar OE "Dauti Komerc" sh.p.k., i cili përmes parashtrësës me shkrim është përgjigjur: "*Ne si OE jemi të tronditur se si mundet një AK, siç është: Ndërmarrja Publike banesore, të merr kësi lloj vendimi/kërkesë ku pa asnjë bazë të qëndrueshme dhe pa asnjë komunikim me ne, duke u bazuar në nenin 99 paragrafi 2 i cili është vetëm për raste si: me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar, që nuk ka të bëjë me rastin tonë, akuzon dhe merr vendim për një kërkesë të tillë pa i llogaritur pasojat dhe dëmet që mund të na shkaktoj neve si Kompani. Pasi që sipas nenit 99 paragrafi 2 i L.P.P thuhet se: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtoj dhe të diskualifikojë O.E nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare. Ne si kompani në tenderin e shpallur nga: Ndërmarrja Publike Banesore me nr. Prokurimi: 1909466981031194-23-3640-1-3-6 për: Furnizim me pije për byfe nuk kemi paraqit të dhëna të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar. Ne kemi vë re pas hapjes së tenderit dhe paraqitjes së procesverbalit të hapjes në e-Prokurim që jemi shumë më të lire se O.E të tjerë dhe pas kontrollimit të ofertës kemi konstatuar që gjatë plotësimit të ofertës kemi gabuar te: Artikulli nr. 10 (Ujë mineral natyral 05 l) te cilin e kemi ofrua me çmim prej 0,13 euro për litër që në fakt 0.13 euro është çmimi për cope 500 ml. dhe çmimi për litër realisht kushton 0,26 euro. Pas konstatimit të gabimit në ofertën tonë e kemi informuar AK për gabimin e ndodhur një ditë pas hapjes së tenderit me email ku edhe e kemi njoftuar për tërheqje, mirëpo nuk kemi pasur asnjë reagim apo njoftim nga ana e AK as me email as me bisede telefonike, duke e pasur parasysh faktin?*

se tek i njëjti AK, për dy vite kemi qene furnizues të po kësaj kontrate dhe madje kemi edhe referenca të mëhershme pozitive nga ana e tyre, dhe sikur AK të na kishte njoftuar se do të ndërmerrte këto masa, ne do të kishim qëndruar pas ofertës edhe me çmimin e gabuar të ofruar, mirëpo nuk e kemi ditur se ai veprim i joni do të sjelle deri në këtë gjendje situatën. Deklarojmë që tërheqja jone nga tenderi ka ndodhur nga gabimi i një punëtori dhe mosdija se kjo mund të shkakton problem të tillë, e pastaj edhe mos komunikimi nga ana e AK, të cilët pa na informuar apo kontaktuar fare kanë paraqitur kërkesë për zbatim të nenit 99 paragrafi 2 pranë OSHP. Pra, tërheqja nuk është bërë për arsye tjera siç mund të pretendohet se mundë të kemi marrëveshje me kompanitë tjera që kanë ofertuar tek po i njëjti tender. Si kompani, ne gjatë vitit 2022 kemi pasur një qarkullim prej rreth 25,000,000.00€ dhe nuk është në interesin tonë që të na futni në listën e zeze për një gabim që kushton rreth 2,736.84€, që AK pretendon se ju është shkaktuar nga ana jonë. Mirëpo, OE nuk mund të shkaktojë dëmtim të buxhetit ndaj AK, përderisa nuk është nënshkruar kontrata. Ndërsa, sa i përket nenit 25.9 të Rregullores për Prokurim Publik me nr 001/2022, ne jemi tërhequr nga tenderi në momentin pas hapjes së tenderit, dhe pa na i kërkuar të dorëzojmë dokumentet për kërkesat e përshtatshmërisë, që kërkohen para shpalljes së fituesit, pra kërkesat e përshtatshmërisë nuk na janë kërkuar fare as pastaj. Të bashkangjitur e gjeni paramasën (ofertën) tonë, emalin e dërguar te AK, referencën pozitive të mëhershme nga i njëjti AK dhe deklaratat tatimore vjetore me pasqyrat financiare. Kërkojmë që kërkesa për zbatim të nenit 99 paragrafi 2, nga AK: Ndërmarrja Publike Banesore, duke iu referuar të dhënave me lartë dhe duke u bazuar në ligjin për prokurim publik të Republikës së Kosovës të merret si e pabazë.”

Paneli shqyrtues pas analizimit të akteve dhe veprimeve të palëve dhe pretendimeve reciproke të tyre, konstaton se në lënda në rastin konkret përmban dokumente dhe shkresa të mjaftueshme, mbi bazën e të cilave Paneli ka të drejtë të vendos në aspektin meritator pa prezencën e palëve, sikurse parashihet kjo me nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP.

Gjatë administrimit të provave, vlerësimit të tyre, paneli shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 99.2 të LPP-së, marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit ka prezantuar dokumente të falsifikuara, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave të rreme ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, në të cilin thuhet: *Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.*

OSHP ndërmerr masa ndaj Operatoreve ekonomik, konform nenit 99 të LPP-së, në atë rast kur AK argumenton para Panelit Shqyrtues se OE në fjalë ka prezantuar dokumente të falsifikuara, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave të rreme. Andaj duke pas për bazë arsyet e cekura me lartë si nga Autoriteti Kontraktues njëkohësisht edhe nga Operatori Ekonomik Paneli Shqyrtues vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me mashtrim apo falsifikim të ndonjë dokumenti për marrjen e masave në kuptim të nenit 99 paragrafi 2 i LPP-së, dhe si rezultat i kësaj refuzohet kërkesa e AK-së për diskualifikim të OE “Dauti Komerc” SHPK. për periudhën një vjeçare.

Paneli shqyrtues pas analizimit të akteve dhe veprimeve të palëve dhe pretendimeve reciproke të tyre, konstatoj se autoriteti kontraktues në kërkesën e tij për diskualifikim ka dhënë shpjegime se cilat janë arsyet që pretendon që OE të diskualifikohet, por që OE në shkresën e tij ka paraqitur arsyet konkrete lidhur me rastin konkret duke e shpjeguar gjithë rrjedhën e rastit. Andaj konstatohet se nga kërkesa e AK dhe faktet e vërtetuara në mënyrë të pavarur nga OSHP dhe të shpjeguara si më sipër, nuk mund të konsiderohen prova të mjaftueshme se duhet të diskualifikohet OE “Dauti Komerc” sh.p.k., ashtu siç pretendon AK.

Por me qenë se OE “Dauti Komerc” sh.p.k., është tërhequr/nuk ka nënshkruar kontratën për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pije për byfe” me numër të prokurimit: 1909466981031194-23-3640-1-3-6, Paneli Shqyrtues ka vlerësuar që të bëhet konfiskimi i tenderit, ashtu që urdhërohet AK, respektivisht Ndërmarrja Publike Banesore, që ta bej konfiskimin e sigurisë së tenderit për OE në fjalë.

Pra, mbi bazën e të lartcekurave Paneli Shqyrtues sipas gjykimit të pavarur të këtij Paneli konsideron se në këtë rast nuk lind objektivisht detyrimi i OSHP, që ta zbatoj dispozitën e cituar si më sipër të LPP, sipas së cilës shprehimisht kërkohet që operatori ekonomik në rastin konkret të diskualifikohet nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit, andaj refuzohet kërkesa e Autoritetit Kontraktues - Ndërmarrja Publike Banesore e datës 18.05.2023.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

- AK- Ndërmarrja Publike Banesore
- OE “Dauti Komerc” sh.p.k
- Arkivës së OSHP-së;
- Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së